



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A	09.01.2025
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji DHJETOR 01.12.2024-31.12.2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Dhjetor, DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

Shkolla “Adem Gllavica,, me datë 05.12.2024, ka pranuar një donacion nga ambasadori gjerman, i cili ka qenë edhe në vizitë në këtë shkollë me përfaqësuesit të Baki Automobile, donacion ky që ofron përmirësimin e kushteve të shkollës dhe ofrimin e një mjedisi më të mirë për nxënësit.

Me datë 05.12.2024, është hap konkursi për pozitën Drejtor në disa shkolla.

Është mbajtur punëtorja për Riatëdhësim në Prevallë, ku ka marrë pjesë zyrtari i dka-së.

Kemi bërë kërkesë prokurimit për furnizimin i IEA me dru.

Me 24.12.2024 ka përfunduar gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor

Me datë 24.12.2024 është bërë shpallja për aplikimin e bursave për student, ku do të jipen 400 bursa.

Me 27.12.2024 është hap konkursi për Edukatore, Motër Edukatore dhe për Asistent/e i fëmijëve me nevoja të veqanta.

Gjithashtu është bërë dorëzimi i raporteve vjetore nga shkollat.

Me datë me 30.12.2024 është hapur konkursi për Zyrtar Administrativ në QEAP Qerdhja në Rufe të Ri, si dhe është hap konkursi për punëtor teknik në Shfmu ‘Migjeni’ Rufe I Ri pnf Hallaq I Madhë.

Është bërë përmbyllja e vitit buxhetor për vitin 2024.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë:

a). Paga&meditje

b). Mallra&komunali

c). Komunali

Zotimet në kategorinë mallra & shërbime dhe komunali.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

